



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 190, datë 22.06 2020

**“PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE DHE FORMATIT TË
VETËDEKLARIMIT PËR RIFRESKIMIN E DOSJEVE PERSONALE TË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 88, pika 7 e ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Përmbarruesit gjyqësorë privat kanë detyrimin të dorëzojnë pranë Ministrisë së Drejtësisë, dosjen personale të plotë të rifreskuar, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.
2. Dosja e plote e dokumentacionit, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, depozitohet brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, përmes shërbimit postar, në adresë të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Dokumentacioni që dorëzohet duhet të jetë në origjinal ose kopje e njësuar me të dhe duhet të përmbajë:
 - a) 2 fotografi, (me përmasa 4 cm x 5cm);
 - b) Kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);

- c) Formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentacionin e përkatës të kërkuar sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri;
 - d) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar;
 - e) Formularin e vetëdeklarimit mbi fillimin, vijimin, pezullimin, masat disiplinore, ose shkëputjen nga ushtrimi aktiv i veprimtarisë përmbartimore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij Urdhri dhe pjesë përbërëse e tij;
 - f) Modular i të dhënave të fillimit, vijimit, pezullimit dhe ushtrimit aktiv të veprimtarisë përmbartimore, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij Urdhri dhe pjesë përbërëse e tij;
4. Formularët e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 1 dhe shtojcës nr. 2, si dhe modulari sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij Urdhri, duhet të plotësohen elektronikisht dhe të përcillen të nënshkuara përmes postës në adresë të Ministrisë së Drejtësisë. Formularët duhet të mbajnë vulën personale të përmbartuesit.
 5. Pasqyrimi i të dhënave të rreme në formularët e vetëdeklarimit, fshehja ose mosdeklarimi i të dhënave që janë të detyrueshme për t'u deklaruar sipas këtij urdhri ose ligjit për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat pavarësisht nëse përbën vepr penale, në çdo rast përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor. Përpunimi i të dhënave të depozituara sipas këtij Urdhri, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
 6. Në rastet kur në dokumentacionin e dorëzuar që përbën dosjen personale të rifreskuar vërehen mangësi, struktura përgjegjëse i kërkon përmbartuesit gjyqësor plotësimin e mangësive brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.
 7. Struktura përgjegjëse, në Ministrinë e Drejtësisë kryen verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga përmbartuesi gjyqësor privat, brenda 15 ditëve nga administrimi i dosjes dhe i paraqet Ministrin e Drejtësisë, raportin e vlerësimit për secilën dosje.
 8. Në rastet kur gjatë verifikimit të dokumentacionit që përbën dosjen personale të rifreskuar, të dorëzuar nga përmbartuesi gjyqësor privat, konstatohen problematika që, sipas nenit 28 të ligjit Nr. 26/2019 "Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat", mund të çojnë në heqjen e licencës, struktura përgjegjëse informon Ministrin e Drejtësisë për marrjen e masave për ndjekjen e procedurës përkatëse ligjore.
 9. Mosrespektimi i kërkesave të këtij Urdhri nga përmbartuesi gjyqësor privat përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 10. Dokumentacioni i administruar sipas këtij urdhri, numërtohet dhe pasqyrohet në fletën epasqyrës së dokumenteve të dosjes të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të saj ose

të bashkëlidhur në kapak me vulën e Ministrisë së Drejtësisë dhe administrohen fizikisht në Sektorin e Arkiv Protokollit.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
12. Ky Urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe i përcillet Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për bërjen e njoftimeve pranë përmbaruesve gjyqësorë privatë, mbi detyrimin për rifreskimin e dosjeve personale dhe dorëzimin e formularëve të vetëdeklarimit, brenda afateve të përcaktuara në këtë urdhër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)



Shtojca nr. 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT

Në zbatim të urdhrin nr. _____, datë _____.2020 të Ministrit të Drejtësisë bashkëlidhur do të gjenden dokumentet origjinale ose në kopje të njësuara me origjinalin , dhe dokumentat përkatëse të nënshkuara,të përmbauesit gjyqësor privat _____, sot në datën _____.2020.

- Curriculum Vitae (shoqëruar me 2 foto 2020 me përmasat 4x5; gjeneralitet; adresa elektronike zyrtare; numër tel./cel.; kontakti; statusi familjar; vendlindja; vendbanimi, të dhëna mbi arsimin parauniversitar dhe arsimin universitar; të dhëna mbi punësimin pas/ose gjatë periudhës së kryerjes së arsimit universitar deri ditën e certifikimit si përmbaues gjyqësor dhe/ose përgjatë tij, certifikime, specializime dhe tituj shkencor) (___fletë)
- Emërtesa dhe adresa e zyrës së përmbaimit (ekstrakti i thjeshtë nga QKB) (___fletë)
- Kopje e certifikatës/licencës së përmbaimit gjyqësor privat (1 fletë)
- Kopje e certifikatës së regjistrimit si person fizik
- Kopje e certifikatës së regjistrimit pranë organit tatimor (nëse është rasti)
- Kopje e librezës së punës dhe dokumenta që vërtetojnë eksperiencën e punës sipas kushteve për certifikimin e përmbauesit gjyqësor privat
- Vërtetim regjistrimi pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaimit Gjyqësor Privat
- Adresa e vendbanimit (vërtetim banimi) (1 fletë)
- Diploma e studimeve universitare (1 fletë) e njësuar me origjinalin
- Certifikata e njohurive të gjuhës së huaj (___fletë) e njësuar me origjinalin
- Modulari i plotësuar i të dhënave të fillimit, vijimit dhe ushtrimit efektiv aktiv të veprimtarisë përmbaimore (___fletë)
- Formular i vetëdeklarimit të komenteve mbi fillimin, vijimin ose shkëputjen nga ushtrimi efektiv aktiv i veprimtarisë përmbaimore (___fletë)

DEKLARUESI- Përmbauesi Gjyqësor Privat _____

Shtojca nr. 2

MODULARI I TË DHËNAVE T FILLIMIT, VIJIMI DHE USHTRIMIT EFEKTIV-AKTIV TË VEPRIMTARISË PËRMBARIMORE TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

	Jana	Shku	Ma	Pri	Ma	Qersh	Korri	Gus	Shtat	Teto	Nënt	Dhjet
	r	rt	rs	ll	j	or	k	ht	or	r	or	or
201												
0												
201												
1												
201												
2												
201												
3												
201												
4												
201												
5												
201												
6												
201												
7												
201												
8												
201												
9												
202												
0												

Nënshkrimi dhe vula e përmbaruesit gjyqësor privat

Shënime:

Plotëso me + kutinë për të konfirmuar periudhën e ushtrimit të veprimtarisë përmbarimore.

Shenja + tregon se përmbaruesi ka qenë aktiv dhe po ushtron funksion publik me kohë të plotë.

Shenja – tregon se përmbaruesi nuk ka ushtruar aktivitet në muaj të caktuar. (arsyet tregohen në format të veçantë)

Sot, në datë __. __. 2020

**FORMULAR I VETËDEKRALIMIT TË KOMENTEVE MBI FILLIMIN,
VIJIMIN OSE SHKËPUTJEN NGA USHTRIMI EFEKTIV AKTIV I
VEPRIMTARISË PËRMBARIMORE**

Sot më datë _____.____2020, unë përmbaruesi gjyqësor privat, _____
deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam filluar të ushtroj aktivitetin dhe veprimtarinë
përmbarimore në muajin _____ dhe vitin _____, pasi jam pajisur me certifikatën
përmbarimore me nr. _____, viti _____.

Aktivitetin e kam filluar si person fizik/person juridik. (tregohet zyra përmbarimore)

Kam patur shkëputje në ushtrimin e aktivitetit. (tregohet shkaku, arsyeja dhe periudha, nuk
shënohen shkëputjet për arsye shëndetësore dhe/ose leje vjetore jo m pak se 30 ditë).

Kam patur pezullim në ushtrimin e aktivitetit. (tregohet shkaku, arsyeja dhe periudha, nuk
shënohen shkëputjet për arsye shëndetësore dhe/ose leje vjetore jo m pak se 30 ditë).

Kam patur masë disiplinore në ushtrimin e aktivitetit ose jo.

Aktualisht kam ushtruar detyrën publike të përmbaruesit gjyqësor privat gjithnjë tek i njëjti subjekt përmbarimor _____ (emër subjekti dhe NUIS), dhe/ose subjekte të tjera përmbarimore _____ (tregohet dhe/ose shënohet subjekti dhe NUIS)

Sot ushtroj detyrën e përmbaruesit privat në zyrën e përmbarimit (shënohet emri i zyrës dhe NUIS) _____ me adresë: _____

DEKLARUESI- Përmbaruesi Gjyqësor Privat

(emër, mbiemër, firmë, vulë)